



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, duke vendosur sipas kërkesave për rishqyrtim të OE "Zahiri" Sh.P.K. (Lot 7) të datës 28.02.2024, të "VZ Company" Sh.P.K. (Lot 2) të datës 27.02.2024, të OE "Via Egnatia Sh.P.K." (Lot 1, 2, 4, 5, 6, 7, 8, 9 dhe 14) të datës 28.02.2024, të OE "TSR" Sh.P.K. (Lot 2, 7 dhe 8) të datës 28.02.2024, të OE "RSM" Sh.P.K. (Lot 1, 2, 3, 4, 6, 7, 8 dhe 9) të datës 28.02.2024, të OE "El-Bau" Sh.P.K. (Lot 3) të datës 28.02.2024, të OE "AVAG Group" Sh.P.K. (Lot 11) të datës 28.02.2024 si dhe të OE "ANUAR" Sh.P.K. (Lot 2 dhe 8) të datës 28.02.2024, kundër njoftimit mbi vendimin të datës 23.02.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Mirëmbajtja dimërore e rrugëve dhe trotuareve deblokimi i kanalizimit atmosferik" me nr. të prokurimit 616-23-13231-2-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim e OE "Zahiri" Sh.P.K. e datës 28.02.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues (Lot 7).**
- II. REFUZOHET si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim e OE "VZ Company" Sh.P.K e dt. 27.02.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues (Lot 2).**
- III. MIRATOHET si pjesërisht e bazuar kërkesa për rishqyrtim e OE "Via Egnatia" Sh.P.K. e datës 28.02.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues (Lot 1, 2, 4, 5, 6, 7, 8, 9 dhe 14).**
- IV. MIRATOHET si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e OE "TSR" Sh.P.K. e datës 28.02.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues (Lot 2, 7 dhe 8).**
- V. MIRATOHET si pjesërisht e bazuar kërkesa për rishqyrtim e OE "RSM" Sh.P.K. e datës 28.02.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues (Lot 1, 2, 3, 4, 6, 7, 8 dhe 9).**
- VI. REFUZOHET si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim e OE "El-Bau" Sh.P.K. e datës 28.02.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues (Lot 3).**
- VII. REFUZOHET si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim e OE "AVAG Group" Sh.P.K. e datës 28.02.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues (Lot 11).**

VIII. MIRATOHET si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e OE "ANUAR" Sh.P.K. e datës 28.02.2024 e datës 28.02.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues (Lot 2 dhe 8).

IX. ANULOHET pjesërisht njoftimi mbi vendimin i datës 23.02.2024 i autoritetit kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit me titull "Renovimi dhe përmisimi i Infrastrukturës së objekteve të KPSH-së" me nr. të prokurimit 616-23-4220-5-1-1 për Lotet 1, 2, 4, 5, 6, 7, 8, 9 dhe 14 ndërsa **VËRTETOHET** njoftimi mbi vendimin për Lotet 3, 10, 11 dhe 12 për të cilat mbetet në fuqi vendimi.

X. DETYROHET autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të dërgoj në **RIVLERËSIM** aktivitetin e prokurimit me titull "Mirëmbajtja dimërore e rrugëve dhe trotuareve debllokimi i kanalizimit atmosferik" Lotet 1, 2, 4, 5, 6, 7, 8, 9 dhe 14 me nr. të prokurimit 616-23-13231-2-1-1.

XI. NJOFTOHET operatorët ekonomik parashtues si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

XII. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Ndaj njoftimit mbi vendimin e datës 23.02.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Mirëmbajtja dimërore e rrugëve dhe trotuareve debllokimi i kanalizimit atmosferik" me nr. të prokurimit 616-23-13231-2-1-1, brenda afatit ligjor janë pranuar kërkesat për rishqyrtim të OE "Zahiri" Sh.P.K. (Lot 7) të datës 28.02.2024, të "VZ Company" Sh.P.K. (Lot 2) të datës 27.02.2024, të OE "Via Egnatia Sh.P.K." (Lot 1, 2, 4, 5, 6, 7, 8, 9 dhe 14) të datës 28.02.2024, të OE "TSR" Sh.P.K. (Lot 2, 7 dhe 8) të datës 28.02.2024, të OE "RSM" Sh.P.K. (Lot 1, 2, 3, 4, 6, 7, 8 dhe 9) të datës 28.02.2024, të OE "El-Bau" Sh.P.K. (Lot 3) të datës 28.02.2024, të OE "AVAG Group" Sh.P.K. (Lot 11) të datës 28.02.2024 si dhe të OE "ANUAR" Sh.P.K. (Lot 2 dhe 8) të datës 28.02.2024.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesave për rishqyrtim të parashtuesve është gjetur se kërkesat janë të lejuara dhe janë parashtuar brenda afatit nga personat e autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar ato. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të këtyre kërkesave.

1. Pretendimet e OE "Zahiri" Sh.P.K. janë se me datë 26.02.2024 ka dorëzuar një letër standarde për sqarime shtesë përmes të cilës ka kërkuar që të njoftohet se cili është vendimi i AK lidhur me OE "Zahiri" Sh.P.K. për Lot 7.

Duhet sqaruar se parashtuesi nuk ka arritur që të formuloj pretendime ankimore konkrete në kërkesën e tij për rishqyrtim por vetëm ka njoftuar se ka dërguar letrën standarde mbi sqarimet shtesë.

Fillimisht duhet cekur se sqarimet shites janë dërguar pas njoftimit mbi vendimit dhe pas përfundimit të procesit të vlerësimit prandaj këto sqarime si të tilla nuk lejohet me LPP. Megjithatë për t'u përgjigjur në pyetjen e parashtruesi sipas sqarimeve shites, përmes njoftimit mbi vendimin e AK është vendosur që oferta e parashtruesit për Lot 7 të eliminohet si e papërgjegjshme për arsyet e cekura në njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues.

Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet ankimore të OE "Zahiri" Sh.P.K. janë të pabazuara ndërsa kërkesa për rishqyrtim duhet refuzuar si e pabazuar në tërësi.

2. Pretendimet e OE "VZ Company" Sh.P.K. janë se nuk qëndrojnë arsyet sipas njoftimit mbi vendimin për Lot 2 lidhur me OE "VZ Company" ku thuhet se parashtruesit i mungojnë 2 makineri mbi 8 tonë.

Lidhur me këto pretendime duhet cekur se në dosjen e tenderit për Lot 2 ndër të tjera është kërkuar që të ofrohen 4 kamionë me së paku 8 tonë peshë. Në anën tjetër parashtruesi ka ofertuar me vetëm 2 makineri me mbi 8 tonë ndërsa i mungojnë edhe 2 makineri të tjera të tilla. Në fakt edhe vet parashtruesi në kërkesën për rishqyrtim nuk e mohon faktin se i mungojnë 4 makineri me mbi 8 tonë. Mirëpo në këtë rast pretendon se nuk janë të nevojshëm këto makineri respektivisht i konteston kërkesat e dosjes së tenderit. Sa i përket kundërshtimit të kërkesave në dosjen e tenderit, parashtruesi ka pasur mundësi që të parashtroj kërkesë për rishqyrtim para hapjes së ofertave kundër njoftimit për kontratë ndërsa në këtë fazë nuk mund të kontestohen kërkesat e DT.

Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet ankimore të "VZ Company" Sh.P.K. janë të pabazuara ndërsa kërkesa për rishqyrtim është refuzuar si e pabazuar.

3. Pretendimet e OE "Via Egnatia" Sh.P.K. janë se nuk qëndrojnë arsyet për eliminimin e parashtruesit nga Lot 1 ku thuhet se parashtruesi nuk ka dëshmuar makineritë e kërkuara me dosjen e tenderit dhe njëkohësisht pretendon se tenderuesi i rekomanduar për Lot 9 "ECO CLEAN & ENERGY - IBRAHIM KURRUMELI B.I. - EUROFAMIS SH.A." është i papërgjegjshëm pasi që deklarata për themelimin e grupit të operatorëve ekonomik nuk e përmban numrin e prokurimit të aktivitetit të prokurimit.

Lidhur me këto pretendime duhet sqaruar se komisioni vlerësues ka pasur mundësi që të kërkoj sqarime shites sa i përket Lot 1 ndërsa sa i përket tenderuesit të rekomanduar për Lot 9 duhet cekur se i njëjti ka dorëzuar një marrëveshje për themelim të konzorciumit ku është cekur titulli dhe numri i aktivitetit të prokurimit dhe 3 deklarata tjera përcjellëse ku nuk është cekur titulli dhe numri i aktivitetit të prokurimit.

Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet ankimore të OE "Via Egnatia" Sh.P.K. janë pjesërisht të bazuara ndërsa kërkesa për rishqyrtim është miratuar si pjesërisht e bazuar.

- 4. Pretendimet e OE "TSR" Sh.P.K. janë se** nuk qëndrojnë arsyet për të cilat është eliminuar parashtruesi për lot 2, 7 dhe 8 sipas të cilave nuk ka dëshmuar makineritë e kërkuara me dosjen e tenderit.

Lidhur me këto pretendime duhet sqaruar se në njoftimin mbi vendimin thuhet se parashtruesit i mungojnë makineritë përkatëse mirëpo nuk specifikohet se cilat makineri pasi që nga oferta e parashtruesit mund të evidentohet se ai ka dorëzuar dëshmi për makineri mirëpo arsyeja për eliminimin e tij është shumë e përgjithësuar dhe nuk dihet se konkretisht për cilat makineri është fjala. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet ankimore të "TSR" Sh.P.K. janë të bazuara dhe kërkesa është miratuar si e bazuar.

- 5. Pretendimet e OE "RSM" Sh.P.K. janë se** tenderuesit e rekomanduar për lotet 1, 3, 4, 6 dhe 9 kanë dorëzuar oferta të papërgjegjshme.

Lidhur me këto pretendime fillimisht duhet cekur se parashtruesi është eliminuar si tenderues i papërgjegjshëm për Lot 3 prandaj parashtruesi nuk është palë e interesuar në raport me pretendimet e tij lidhur me lot 3 në kuptim të nenit 4 par. 1 nënpar. 26 të LPP ku përcaktohet se *"Palë e interesuar - personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi duke përfshirë cilindo person i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar"*. Rrjedhimisht parashtruesi nuk mund të dëshmojë asnjë interes material nga cilido rezultat lidhur me këtë lot. Prandaj pretendimet për lot 3 janë stë pabazuara ndërsa pretendimet për lotet tjera janë pjesërisht të bazuara. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet ankimore të OE "RSM" Sh.P.K. janë pjesërisht të bazuara ndërsa kërkesa për rishqyrtim është miratuar si pjesërisht e bazuar.

- 6. Pretendimet e OE "El - Bau" Sh.P.K. janë se** opertori ekonomik RSM Sh.P.K. dhe tenderuesi i rekomanduar për lot 3 "Via Egnatia" kanë dorëzuar ofertë të papërgjegjshme. Sa i përket pretendimeve ankimore të drejtuara kundër RSM duhet cekur se parashtruesi në raport me këto pretendime nuk është palë e interesuar në kuptim të nenit 4 par. 1 nënpar. 26 të LPP pasi që RSM nuk është rekomanduar për Lot 3 mirëpo është rekomanduar një tenderues tjetër. Prandaj këto pretendime janë të pabazuara. Pretendimet e parashtruesit kundër tenderuesit të rekomanduar "Via Egnatia" janë se nuk ka dëshmuar makineritë e kërkuara, njëkohësisht është ofertuar me çmime jonormalisht të ulëta si dhe një nga anëtarët ka lidhur marrëveshje me ATK për shlyerjen e borxhit. Sa i përket pretendimit lidhur me marrëveshjen e njërit prej anëtarëve të GOE "Rahovica Commerce" me ATK për shlyerjen e borxhit, duhet sqaruar se ky pretendim është i pabazuar për faktin se tenderuesi i rekomanduar për lot 3 si konzorcium i ka përmbushur kërkesat e dosjes së tenderit mbi gjendjen ekonomik dhe financiare (ky fakt nuk kontestohet fare as nga parashtruesi). Ndërsa sa i përket pjesës së marrëveshjes duhet sqaruar se marrëveshja është lidhur para datës së publikimit të njoftimit për kontratë (fakt që nuk kontestohet nga parashtruesi). Rrjedhimisht kjo marrëveshje është e lejuar sipas LPP dhe kjo konfirmohet ndër të tjera edhe përmes interpretimit të KRPP nr. 6 të datës 22.11.2022 ku ndër të tjera thuhet se *"KRPP sqaron se edhe në këtë rast marrëveshjet për shlyerje të borxheve duhet të jetë para datës së publikimit të njoftimit të kontratës"*.

Sa i përket pjesës së pretendimeve lidhur çmimet jonormalisht të ulëta nuk janë përmbushur sipas nenit 41 par. 41.3 të RRPP ku përcaktohet *"41.3 Autoritetet kontraktuese do të kërkojnë nga operatorët ekonomik për të shpjeguar çmimin e ofruar për tenderët e përgjegjshëm, kur të përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme: i. çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm; ii. çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët; iii. janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë"*. Sa i përket pjesës makinerive, sipas komisionit vlerësues është konfirmuar se tenderuesi i rekomanduar ka dorëzuar të gjitha dëshmitë dokumentare për makineritë e kërkuara sipas dosjes së tenderit. Në anën tjetër as parashtruesi nuk ka argumentuar të kundërtën me dëshmi bindëse. Sa i përket pretendimeve tjera ankimore lidhur me plotësimin e listës së kontratave, sipas raportit të komisionit vlerësues dhe sipas ofertës së tenderuesit të rekomanduar është konfirmuar se lista është plotësuar dhe dorëzuar në përputhje të plotë me DT. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet ankimore të OE "El-Bau" Sh.P.K. janë të pabazuara ndërsa kërkesa për rishqyrtim është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

7. Pretendimet e OE "AVAG Group" Sh.P.K. janë se opertori ekonomik Alko Impex dhe tenderuesi i rekomanduar për lot 11 "Via Egnatia" kanë dorëzuar ofertë të papërgjegjshme. Sa i përket pretendimeve ankimore të drejtuara kundër Alko Impex duhet cekur se parashtruesi në raport me këto pretendime nuk është palë e interesuar në kuptim të nenit 4 par. 1 nënpar. 26 të LPP pasi që Alko Impex nuk është rekomanduar për Lot 11 mirëpo është rekomanduar një tenderues tjetër. Prandaj këto pretendime janë të pabazuara. Pretendimet e parashtruesit kundër tenderuesit të rekomanduar "Via Egnatia" janë se nuk ka dëshmuar makineritë e kërkuara, njëkohësisht është ofertuar me çmime jonormalisht të ulëta si dhe një nga anëtarët ka lidhur marrëveshje me ATK për shlyerjen e borxhit. Sa i përket pretendimit lidhur me marrëveshjen e njërit prej anëtarëve të GOE "Rahovica Commerce" me ATK për shlyerjen e borxhit, duhet sqaruar se ky pretendim është i pabazuar për faktin se tenderuesi i rekomanduar për lot 11 si konzorcium i ka përmbushur kërkesat e dosjes së tenderit mbi gjendjen ekonomik dhe financiare (ky fakt nuk kontestohet fare as nga parashtruesi). Ndërsa sa i përket pjesës së marrëveshjes duhet sqaruar se marrëveshja është lidhur para datës së publikimit të njoftimit për kontratë (fakt që nuk kontestohet nga parashtruesi). Rrjedhimisht kjo marrëveshje është e lejuar sipas LPP dhe kjo konfirmohet ndër të tjera edhe përmes interpretimit të KRPP nr. 6 të datës 22.11.2022 ku ndër të tjera thuhet se *"KRPP sqaron se edhe në këtë rast marrëveshjet për shlyerje të borxheve duhet të jetë para datës së publikimit të njoftimit të kontratës"*. Sa i përket pjesës së pretendimeve lidhur çmimet jonormalisht të ulëta nuk janë përmbushur sipas nenit 41 par. 41.3 të RRPP ku përcaktohet *"41.3 Autoritetet kontraktuese do të kërkojnë nga operatorët ekonomik për të shpjeguar çmimin e ofruar për tenderët e përgjegjshëm, kur të përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme: i. çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm; ii. çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët; iii. janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë"*.

Sa i përket pjesës makinerive, sipas komisionit vlerësues është konfirmuar se tenderuesi i rekomanduar ka dorëzuar të gjitha dëshmitë dokumentare për makineritë e kërkuara sipas dosjes së tenderit. Në anën tjetër as parashtruesi nuk ka argumentuar të kundërtën me dëshmi bindëse. Sa i përket pretendimeve tjera ankimore lidhur me plotësimin e listës së kontratave, sipas raportit të komisionit vlerësues dhe sipas ofertës së tenderuesit të rekomanduar është konfirmuar se lista është plotësuar dhe dorëzuar në përputhje të plotë me DT. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet ankimore të OE "AVAG Group" Sh.P.K. janë të pabazuara ndërsa kërkesa për rishqyrtim është refuzuar si e pabazuar.

8. Pretendimet e OE "ANUAR" Sh.P.K. janë se nuk qëndrojnë arsyet për të cilat është eliminuar parashtruesi për lot 2 dhe 8 sipas të cilave nuk ka dëshmuar makineritë e kërkuara me dosjen e tenderit.

Lidhur me këto pretendime duhet sqaruar se në njoftimin mbi vendimin thuhet se parashtruesit i mungojnë makineritë përkatëse mirëpo nuk specifikohet se cilat makineri pasi që nga oferta e parashtruesit mund të evidentohet se ai ka dorëzuar dëshmi për makineri mirëpo arsyeja për eliminimin e tij është shumë e përgjithësuar dhe nuk dihet se konkretisht për cilat makineri është fjala. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet ankimore të OE "ANUAR" Sh.P.K. janë të bazuara ndërsa kërkesa për rishqyrtim është miratuar si e bazuar.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi ashtu që Njoftimi mbi Vendimin është anuluar pjesërisht dhe atë vetëm sa i përket Lot 1, 2, 4, 5, 6, 7, 8, 9 dhe 14 për të cilat lote është kthyer në rivlerësim aktiviteti i prokurimit ndërsa është vërtetuar Njoftimi mbi Vendimin sa i përket Lot 3, 10, 11 dhe 12 për të cilat është autorizuar autoriteti kontraktues që të vazhdoj tutje me aktivitetin e prokurimit.

Për pikat I deri VIII të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1. të RRPP. Për pikat IX deri XII të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. dhe 63.3. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 06.03.2024



Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.